

# AKSIDENTET RRUGORE

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure  
(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

## Përmbajtja

1. Kontakt .....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore .....	2
4. Njësia matëse .....	3
5. Periudha e referencës .....	3
6. Mandati institucional .....	3
7. Konfidencialiteti .....	4
8. Politika e botimit .....	4
9. Shpeshësia e shpërndarjes .....	4
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia .....	4
11. Manaxhimi i cilësisë .....	5
12. Rëndësia .....	6
13. Saktësia dhe besueshmëria .....	6
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	7
15. Koherenca dhe Krahueshmëria .....	7
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	7
17. Rishikimi i të dhënave .....	7
18. Përpunimi statistikor .....	7
19. Komente .....	8
Aneks .....	8

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave , INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Tregtisë së Jashtme, Transportit dhe Turizmit
1.3. Personi i kontaktit	Zhuljeta Lubonja
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialiste në Sektorin e Tregtisë së Jashtme, Transportit dhe Turizmit
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë.
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:zlubonja@instat.gov.al">zlubonja@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	22/10/2018
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	22/10/2018
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Të dhënat mbi aksidentet rrugore ofrojnë informacion për aksidentet rrugore dhe të aksidentuarit në nivel vendi dhe rajoni. Informacioni statistikor rreth aksidenteve rrugore është një tregues mujor i cili paraqet dinamikën e aksidenteve rrugore.</p> <p>Të dhënat të cilat INSTAT grumbullon dhe publikon mbi aksidentet rrugore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numrin e aksidenteve rrugore</li> <li>• Të aksidentuarit, të ndarë të vdekur dhe plagosur, si edhe femra meshkuj</li> <li>• Aksidentet sipas pëdoruesve të rrugës</li> <li>• Të vdekurit sipas pëdoruesve të rrugës</li> <li>• Aksidentet sipas moshës së drejtuesit të mjetit</li> <li>• Aksidentet rrugore sipas qarqeve</li> <li>• Të vdekurit sipas qarqeve.</li> </ul>

3.2. Sistemi i klasifikimit	Nuk aplikohet.
3.3. Mbulimi i sektorit	Informacioni statistikor mbulon të dhëna mbi aksidentet rrugore në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><b>Person i aksidentuar</b> Çdo person i vrarë ose i plagosur si rezultat i një aksidenti rrugor.</p> <p><b>Aksidente në rrugë</b> Një aksident është çdo aksident rrugor i ndodhur nga të paktën një mjet rrugor i cili rezulton me të paktën një person të plagosur apo të vdekur.</p> <p><b>Person i vdekur</b> I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit.</p> <p><b>Person i plagosur</b> I plagosur konsiderohet çdo person , i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore janë numri i aksidenteve dhe të aksidentuarve .
3.6. Popullata statistikore	Të gjitha aksidentet dhe të aksidentuarit.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e aksidenteve rrugore mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Aksidentet rrugore datojnë prej vitit 1995.
3.9. Periudha bazë	Nuk përdoret vit bazë.
<b>4. Njësia matëse</b>	Numri i aksidenteve rrugore dhe i të aksidentuarve.
<b>5. Periudha e referencës</b>	Periudha referuese e informacionit statistikor mbi aksidentet rrugore është mujore që nga viti 2016 dhe tremujor/ vjetor për periudhën 1995-2015. Ky raport i përket vitit referencë 2018.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore për prodhimin e indikatorëve për aksidentet rrugore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare; <a href="http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikatzyrtare.pdf">http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikatzyrtare.pdf</a></li> <li>• Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021; <a href="http://www.instat.gov.al/media/3594/psz-2017-2021.pdf">http://www.instat.gov.al/media/3594/psz-2017-2021.pdf</a></li> <li>• Rregullorja e Këshilit Evropian Nr.1165/98, “Mbi treguesit Afatshkurtër”;</li> <li>• Rregullorja e Komisionit Evropian Nr.1503/2006.</li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e Aksidenteve rrugore nuk transmetohen në EUROSTAT.

## 7. Konfidencialiteti

7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni15 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	Të dhënat publikohen në nivel të agreguar, sipas aksidenteve dhe të aksidentuarve dhe sipas qarqeve (referuar ndarjes administrative). Nuk publikohen të dhëna individuale.

## 8. Politika e botimit

8.1. Kalendari i publikimeve	Rezultatet publikohen 21 ditë pas periudhës referencë (T+21 ditë). Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në kalendarin e publikimeve. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave
8.2. Aksesimi në kalendarin e publikimeve	Kalendari i Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it: <a href="http://www.instat.gov.al/al/publikime/kalendari/">http://www.instat.gov.al/al/publikime/kalendari/</a>
8.3. Aksesimi i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit tremujor të Aksidenteve Rrugore janë si më poshtë: 1. Website – online release 2. Kërkesat e shkruara 3. Publikimi Aksidenteve Rrugore 4. Pjesa e Informacionit të dedikuar për të kontaktuar INSTAT: <a href="http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%C3%ABrkes%C3%AB-t%C3%AB-dh%C3%ABnash/">http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%C3%ABrkes%C3%AB-t%C3%AB-dh%C3%ABnash/</a>

<b>9. Shpeshësia e shpërndarjes</b>	Statistikat e Aksidenteve rrugore publikohen cdo muaj afërsisht 21 ditë pas përfundimit të muajit referencë.
-------------------------------------	--

## 10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia

10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të aksidenteve rrugore. Njoftimi për shtyp i Aksidenteve rrugore
-------------------------	---

	publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	<p>Rezultatet e Aksidenteve rrugore gjenden të botuara në botimin “Aksidentet rrugore”, “Vjetarin Statistikor”, si edhe në “Vjetarin Statistikor Rajonal”. Përdoruesit mund t’i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aksidentet rrugore: <a href="http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/">http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/</a></li> <li>• Vjetari Statistikor: <a href="http://www.instat.gov.al/media/4936/vjetari-statistikor-2018.pdf">http://www.instat.gov.al/media/4936/vjetari-statistikor-2018.pdf</a></li> <li>• Vjetari Statistikor Rajonal: <a href="http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2018/vjetari-statistikor-rajonal-2018/">http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2018/vjetari-statistikor-rajonal-2018/</a></li> </ul>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat mbi Aksidentet rrugore publikohen në faqen zyrtare të INSTAT: <a href="http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/?rxid=1d02682c-c265-448c-826e-6d47fc493822">http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/?rxid=1d02682c-c265-448c-826e-6d47fc493822</a>
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat e Aksidenteve rrugore nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31 Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linku më poshtë: <a href="http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/na-kontakttoni.aspx">http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/na-kontakttoni.aspx</a>
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologjia mbi Aksidentet Rrugore është e bazuar në manualët dhe rregulloret e EUROSTAT mbi Statistikat e Transportit, të cilat përmbajnë një set të gjerë rekomandimesh mbi plotësimin e treguesve të aksidenteve. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodogjinë mbi aksidentet në linkun e mëposhtëm: <a href="http://instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-shërbimet/transporti-dhe-aksidentet">http://instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-shërbimet/transporti-dhe-aksidentet</a>
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Tregtisë së Jashtme, Transportit dhe Turizmit dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi aksidenteve rrugore për qëllime të brendshme.
<b>11. Menaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr.17/2018, datë 05.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi

	për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e Aksidenteve Rrugore krahasohen me të dhënat e aksidenteve rrugore të një viti më parë për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit mbi Aksidentet Rrugore janë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucione të administratës publike</li> <li>• Universitetet</li> <li>• Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> <li>• Bizneset</li> <li>• Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme.</li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	Page Views (Klikime) në lidhje me Aksidentet Rrugore për vitin 2017 janë rreth 4,452 klikime. Ndërkohë që në vitin 2016 ishin rreth 2,678 klikime. INSTAT gjatë vitit 2017 ka realizuar për herë të parë Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve. Pyetjes: "Si e vlerësoni cilësinë e përgjithshme të statistikave për fushën Transportit?" në shkallën nga 1 tek 5 (1=shumë e dobët, 2=e dobët, 3=e përshtatshme, 4=e mirë, 5=shumë e mirë), përdoruesit kanë vlerësuar cilësinë e të dhënave me një mesatare prej 3,04 . Më poshtë gjeni linkun e rezultateve të Anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve. <a href="http://www.instat.gov.al/media/2974/anketa-mbi-kenaqesine-e-perdoruesve.pdf">http://www.instat.gov.al/media/2974/anketa-mbi-kenaqesine-e-perdoruesve.pdf</a>
12.3. Plotshmëria	Të dhënat e prodhuara mbi Aksidentet Rrugore janë në nivelin më të detajuar të kërkuar: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për numër sipas aksidenteve rrugore;</li> <li>• Numrit të të aksidentuarve (të vdekur apo të plagosur).</li> </ul> Shkalla e Plotshmërisë të të dhënave, për 2018, është 100%. Kjo përlllogaritje ka marrë në konsideratë të dhënat që kërkohen nga EUROSTAT.
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Informacioni mblidhet në mënyrë të listuar dhe nuk është objekt vrojtimi.
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.
13.3. Gabim jo i kampionimit	Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm human. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit. Gabimet e jo- kampionimit trajtohen bazuar në politikën e Trajtimit të Gabimeve.

<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>	
14.1. Afatet kohore	Informacioni mbi aksidentet rrugore publikohet afërsisht 21 ditë pas përfundimit të muajit referues sipas datës së paracaktuar në kalendarin e botimeve të INSTAT.
14.2. Përpikmëria	Të gjitha afatet kohore respektohen në datat e paracaktuara në kalendarin e botimeve. Publikimi i të dhënave si pjese e botimeve të ndryshme të INSTAT, ka qenë i përpiktë në kohë në masën 100% të publikime të kryera gjatë viteve.
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>	
15.1. Krahasueshmëri a gjeografike	Të dhënat mbi Aksidentet Rrugore janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e EUROSTAT dhe si të tilla janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat mbi aksidentet rrugore janë gjithëpërfshirëse, ato prodhohen në nivel vendi dhe sipas qarqeve.
15.2. Krahasueshmëri a kohore	Informacioni statistikor mbi aksidentet rrugore grumbullohet në të njëjtën mënyrë duke datuar nga viti 1995.
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.
15.4. Koherenca e brendshme	Kontrollohen konsistenca e brendshme e të dhënave para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca e tyre në seri të ndryshme. Një ndër to është kontrolli që variablat si: " Numri gjithsej i aksidenteve rrugore" dhe " Numri i aksidenteve rrugore sipas sjelljes së drejtuesit/këmbësorit" janë koherente.
<b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b>	Stafi i përfshirë për të dhënat e Aksidenteve rrugore është 1 punonjës.
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni: <a href="http://www.instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf">http://www.instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf</a> <a href="http://www.instat.gov.al/media/2828/politika_e_trajtimit_te_gabimeve.pdf">http://www.instat.gov.al/media/2828/politika_e_trajtimit_te_gabimeve.pdf</a>
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast se autoritetet lokale të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi aksidentet rrugore do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e muajit të ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit.
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
18.2. Shpeshtësia e	Të dhënat grumbullohen çdo muaj.

grumbullimit të të dhënave	
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat mbi Aksidentet Rrugore janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i aksidenteve rrugore grumbullohet nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave për aksidentet rrugore u janë bërë kontrolle logjike dhe matematike .Këto kontrolle kryhen për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon, gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Mbulimi është gjithëpërfshirës në nivel vendi dhe prefektura, të dhënat janë administrative dhe informacioni statistikor mundësohet përherë në kohë, prandaj vlerësimi i të dhënave nuk është i nevojshëm.
18.6. Rregullimi	Të dhënat mbi Aksidentet rrugore publikohen në shifra absolute dhe në përqindje.
<b>19. Komentë</b>	
<b>Aneks</b>	